



**PROGRAMI ZHVILLIMOR I SHSKUK
2021-25**

Prof. Asoc. Basri Lenjani MD.PhD

Datë: 03.02.2021

Prishtinë

PROGRAMI ZHVILLIMOR I SHSKUK 2021-25

Shërbimi Spitalor Klinik Universitare e Kosovës me programin zhvillimor do të ofroj të gjitha shërbimet shëndetësore për të gjithë qytetarët e Kosovës si dhe do të ofroj ofron shërbime arsimore kërkimore dhe shkencore apo përgatitja e studentëve në aspektin praktik dhe teorik përmes punimeve shkencore në bashkëpunim me Fakultetin e mjekësisë.

Misioni

Ofrimi i kujdesit mjekësor (emergjent) brenda orës së artë dhe ngritja e shansave për mbijetesë në kushte të rregullta dhe në kushte jashtëzakonshme.

Visioni

Përmirësimi i shërbimeve brenda orës së artë dhe ngritja e shansave për mbijetesë në kushte të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Sfidat – ballafaqimet - përmisimet në shërbimeve shëndetësore në Kosovë

Presioni për ndërrime. Sistemi shëndetësor i shërbimeve shëndetësore nuk ka një rrjetë të konsoliduar dhe të integruar të shërbimeve mjekësore në nivel vendi. Në terma ekonomik, investimet në shërbimet shëndetësore përfaqësojnë investime që (nuk/ apo) gjenerojnë të ardhura por që shpëtojnë jetë. Megjithatë konsiderohen si shumë të rëndësishme dhe ndikojnë në kualitetin e jetës dhe shpenzimet e mëtutjeshme të shoqërisë për të rehabilituar të sëmurët me probleme shëndetësore me rrezik jete.

Ballafaqimet sfidat

Mangësitë dhe problemet e konstatuara në shërbimet shëndetësore pranë SHSKUK-së. Shfrytëzimi i ulët i shërbimeve shëndetësore. Mangësia e kapaciteteve diagnostikuese dhe laboratorike për kryerjen e testeve bazë dhe atyre të shpëtimit të jetës. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë referimi. Ndryshimi i sistemit. Nevoja e trajnimeve profesionale fokusuar veçanërisht te mjekët e urgjencës dhe ndihmësit e tyre. Mungesë e standardizimit (shërbimit klinik dhe përkufizimeve). Mbjatje jo e mirë e të dhënave mbi pacientin (SHISH kartelat mjekësore dhe regjistra).

Presioni për ndërrime

Për me tepër ky mund të jepen kahjet e zhvillimit të niveleve të kujdesit Shëndetësor si dhe të bashkëpunimit ndërsektoral. Ky fakt tregon se sistemi i referimit të shërbimeve shëndetësore ngac dhe kontribon në joefikasitetin e shfrytëzimit të resurseve në dispozicion.

Ne disa raste, poashtu kontribon në anashkalimin dhe kërkesave për ofrimin e kujdesit shëndetësor në SHSKUK-së. Kjo ndodh kryesisht për shkak të mungesës së paisjeve, furnizimit të rregullt të barnave, materialit shpenzues si dhe kuadrit shëndetësor të edukuar dhe trajnuar. Problem në vete paraqet dhe mungesa e protokoleve që do të mundësonin vendim marrje korrekte, si në diagnostifikim, trajtim të bazuar në algoritmet, teknikat e përzgjedhjes sipas standardeve ndërkombëtare.

Politika dhe planifikimi

MSh SHSKUK-së vazhdon të përshtatet me ndryshime konstante dhe zhvillime në shoqëri, përmes politikave dhe planifikimeve për të ardhmen. Spektri i shërbimeve shëndetësore në SHSKUK-së është e influencuar nga adaptimi i teknologjive të reja mjekësore dhe oferta e pabalancuar e fuqisë punëtore në SHSKUK-së. Teknologjitë informative dhe komunikative (TIK) të aplikuara të kujdesit shëndetësor kanë ndikim të madh në funksionimin e shërbimeve shëndetësore të cilat për momentin janë në zhvillim kurse ato specifike mungojnë. Kjo gjë e vështëron bashkëpunimin dhe koordinimin të niveleve dhe sektorëve të kujdesit (p.sh. sektori shëndetësor dhe social, kujdesi primar, sekondar, terciar).

Procesi i zhvillimit të të Shërbimeve shëndetësore në SHSKUK-së bazohet në formatin e ofruar nga OBSH dhe tenton që në kontekstin e kujdesit shëndetësor, planit të zhvillimit strategjik të Qeverisë të definojë konturat e afatgjate të projektit që do të funksionojë brenda kontekstit social ekonomik Kosovar. Një plani mirë do të ofron drejtim të hollesishëm dhe instruksione akterëve të ndryshëm në skenën e sistemit shëndetësor emergjent me fokusim në tri nivelet shëndetësore. Një dokument i mirë poashtu definojnë strukturat, aktivitetet dhe afatet kohore për të kontribuar në implementimin e këtij plani.

Procesi i zhvillimit të SHSKUK-së në Kosovë

Një hapi i parë është që të identifikohet arsyetshmëria e e reformave në kujdesin shëndetësor. Hapi i dytë është arritja objektive, qëllimeve dhe procesit të implementimit të shërbimeveshëndetësore. Megjithatë, sfidat e reja që po parashtrihen nga popullta shumë e re, rritja dramatike e gjendjeve emergjente, rritja e numrit të aksidenteve, kërcënimet e epidemive dhe pandemive, etj , shtyejnë shërbimet e kujdesit shëndetsor të rishikohen.

PLANI I PUNËS NË SHSKUK-SË 2021-25 NË VETE KA 4 OBJEKTIVA DHE ATO JANË:

Objektivat

- a. Ofrimi i shërbimeve cilësore shendetësore
- b. Forcimi i rolit monitorues të MSH
- c. Financimi i qëndrueshëm i shërbimeve shendetësore
- d. Sigurimi i resurseve njerëzore dhe kapitale

Objektivat dhe masat e zbatimit

- a. Ofrimi i shërbimeve të sigurta shëndetësore
- b. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore të avansuara dhe emergjente të integruara
- c. Sigurimi dhe zhvillim(burimeve njerëzore) i kuadrit profesional për funksionimin e klinikave të SHSKUK-së
- d. Avancimi i hulumtimeve shkencore

Objektivi 1. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore cilësore dhe të sigurta parasheh 10 aktivitete për të realizuar objektivin

Aktivitetet kryesore janë:

- Ofrimi i shërbimeveshëndetësore brenda kohës së duhur
- Pranimi i të sëmurit dhe të lënduarëve
- Monitormi i të sëmurit dhe të lënduarëve
- Observimi i të sëmurit dhe të lënduarëve
- Përgatitja e procedurave standard për verprimet mjekësore diagnostike laboratorike
- Përgatitja e të sëmurit dhe të lënduarëve për konsulencë specialiste
- Përgatitja e të sëmurit dhe të lënduarëve për marrjen e barnave
- Përgatitja e të sëmurit dhe të lënduarëve për trajtim emergjent
- Informatorët për të sëmurit dhe të lënduarëve
- Plotësimi i dokumentacionit mjekësor

- Përgatitja e të sëmurit dhe të lënduarëve për sistem në Klinikat gjegjëse me kujdes mjekësor
- Fletpëlqimi i pacientit
- Shërbimet e reja
- Zvogëlimi i pritjeve për shërbime mjekësore emergjente

Modernizimi I njësive të SHSKUK-së:

- Sektori i Personelit
- Sektori i Administratës
- Zyra për Çështje Juridike
- Sektori i Buxhetit dhe Financave
- Sektori i Prokurimit
- Sektori i Mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore
- Sektori i Shërbimeve Teknike
- Sektori i ushqimit dhe shërbimit
- Sektori i Sistemit të Informimit Shëndetësorë
- Sektori i Pronës
- Sektori i Farmaceutikës QKUK- SHSKUK-së

Modernizimi e Klinikave të SHSKUK-së si dhe spitaleve regjionale :

- Ngritja e kapaciteteve
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore
- Avansimi dhe fuqizimi i diagnostikes laboratorike dhe diagnostike
- Modernizimi dhe avansimi I Klinikave të SHSKUK-së si dhe spitaleve rajonale të specifikuar me patologji të vecanta
- Edukimi dhe trajnimi I stafit mjekësor për degët specifike të patologjive
- Krijimi i spitaleve speciale
- Sistemi referimit
- Standardet mjekësore
- Standardizimi I SHME

Avansimi dhe fuqizimi dhe modernizimi i shërbimeve në SHSKUK-së dhe në spitale të rrethit

- Klinika emergjente mjekësore
- Njësia e sulmit në zemër në zhvillim
- Njësia e sulmit në tru në zhvillim
- Njësia kirurgjise spinale
- Qendra nacionale për djegie dhe kirurgjia rekonstruktive
- Qendra nacionale e toksikologjise
- Qendra nacionale e trauma
- Qendra nacionale e kujdesit intensive për sëmundje dhe lëndime.
- Spitalet speciale

Standardet e Profesionalizmit Mjekësor

Profesionalizmi mjekësor bazohet në standarde individuale por edhe institucionale. Jo vetëm standarde klinike, por edhe etike, të vlerave e të sjelljes.

Nigel Crisp, 2006

